



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:1711/24 Datë: 20.08.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 127 të mbajtur më datë 12.08.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

I. Nuk riakreditohet programi i studimit i Kolegjit UBT kampusi kryesor në Prishtinë, programi:

- o *Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedisit MSc (R)*

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji UBT brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

| Nr. | Programi i studimit                                | Bartësit e programit       |
|-----|----------------------------------------------------|----------------------------|
| 1.  | <i>Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedisit MSc (R)</i> | Armend Ymeri<br>Sami Gashi |

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit AKA ka organizuar vizitat në Kolegjin UBT kampusi kryesor në Prishtinë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit: *Johannes Falterbaum, Peter Parycek dhe Christoph Back*.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

**Për këtë program të studimit; *Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedisit MSc***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 27.06.2024, të cilën kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht dy (2) ndërsa Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.

Mirëpo me gjithë rekomandimin pozitiv nga ekipi i ekspertëve të jashtëm ndërkombëtarë, KShC kishte kërkuar sqarime shtesë për ndryshimet që ishin bërë në programin Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedisit MSc. Pas pranimit të sqarimeve shtesë nga Kolegji UBT, KShC ka konstatuar se ndryshimet që ishin bërë në Emërtim, kurrikula, lëndë si dhe në tërësinë e programit përfshijnë më tepër se 30 %, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi çdo ndryshim që përfshinë më tepër se 30% të programit konsiderohet Akreditim dhe jo Riakreditim.

Bazuar në Paragrafin 3, nënparagrafin 3.6 të Nenit 37 të ligjit për AKA ku thuhet se, citojmë: *"3. Institucionet e arsimit të lartë obligohen të njoftojnë AKA-në me shkrim për çdo ndryshim të rëndësishëm, përfshirë: ... 3.6. ndryshimin e programit të studimit më shumë se tridhjetë përqind (30%)."*

Pra referuar kësaj dispozite IAL do të duhej të njoftonte me kohë ndryshimet e bëra në program, me qëllim që për këto ndryshime të ishin njoftuar edhe ekipi i ekspertëve të jashtëm ndërkombëtarë të akreditimit.

Referuar kësaj KShC konsideron se Kolegji UBT kishte aplikuar për Riakreditim, e në bazë të ndryshimeve është dashur të aplikoj për Akreditim dhe bazuar në Nenin 18, par. 3 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, citojmë: *"Përjashtimisht, KShC mund të merr vendim ndryshe nga rekomandimi i vlerësuesve të jashtëm, nëse KShC konstaton se gjendja faktike e vërtetuar e raportit nuk është në përputhje me rekomandimin final të vlerësuesve të jashtëm."*

Në rastin konkret, ndryshimet në programin *"Inxhinieri e Energjisë dhe Mjedisit MSc"* ishin të natyrës që nuk e përmbushnin standardin për riakreditim të një programi ekzistues, por përfaqësojnë një rishikim substancial dhe të thellë të përmbajtjes dhe strukturës së programit. Kjo kërkon që aplikimi të kalon në një proces të akreditimit për të siguruar që standardet e cilësisë dhe përputhshmërisë me kornizën ligjore janë zbatuar në tërësi.

Në rast se një program konsiderohet si i ri për shkak të ndryshimeve përmbajtësore dhe të konsiderueshme, ai duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e procedurës së re të akreditimit.

Duke marr parasysh këto aspekte dhe për të ruajtur integritetin dhe standardet e larta të akreditimit, KShC vendosi që mos akreditimi i programit në këtë fazë është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore. Vendimi është marrë për të garantuar që çdo program i ri të plotësojë të gjitha kriteret e nevojshme për akreditim dhe të ofrojë një cilësi të lartë arsimore për studentët.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 127-të, të mbajtur më datë 12.08.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit UBT dhe duke u bazuar në të dhëna e cekur më sipër, në bazë të kompetencave ligjore dhe diskrecionit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit UBT kampusi kryesor në Prishtinë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.